**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

**OSHP: 2023/0990**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE "Alfa Globe" Sh.P.K, kundër Vendimit për anulimit të një aktiviteti të prokurimit të Kuvendi Komunal – Rahovecë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1" më 13/03/2024, mori:

# Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Alfa Globe" Sh.P.K me nr. 2023/990 e datës 07/12/2023, kundër "Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " datës 29.11.2023, të AK Kuvendi Komunal – Rahovec lidhur me anulimin e aktivitetit prokurimit "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1" dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

# Arsyetim

*Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 03.10.2023, Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1". Ndërsa me datën 29.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit kontraktues për anulimin e aktiviteti prokurimit sipas nenit 44.6 te RROUPP.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 300,000.00 €.

Me 01.12.2023, OE "Alfa Globe" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 04.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Më 07.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Alfa Globe" Sh.P.K me nr. 990/23 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alfa Globe" Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon: " Kërkojmë nga PSH i OSHP-së që të detyrojë Autoritetin Kontraktues të kthejë lenden në Rivlerësim, dhe të rivlerësohet lënda duke e respektuar LPP-në ,pasi qe në bazë të kërkesave të njoftimit për kontratë dhe FTD të dosjes se tenderit Grupi i Operatoreve Ekonomik ALFA GLOBE & EOR GROUPSHPK i plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe FTD të dosjen e tenderit dhe një heri jemi grupi i OE-ve i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Krejt këtë e vërteton edhe fakti se vetë Autoriteti Kontraktues me 22.11.2023 shpall Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku shpërblen me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk. Kërkojmë nga PSH i OSHP-së që të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e datës 29.11.2023 që përmbajnë shkelje të rënda të dispozitave të LPP-së dhe të kthej vendimin e datës 22.11.2023, që është vendim i drejtë dhe në pajtueshmëri me kërkesat e FTD-së dhe dispozitat e LPP-së. Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të shpërblehet me kontratë grupin e OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk dhe të anulojë vendimin e datës 29.11.2023. Duke marr për bazë Njoftimin mbi vendimin e AK-së te datës 29.11.2023, ky vendim i Autoritetit Kontraktues është në kundërshtim me të dispozitave të LPP-së dhe AK-ja ka shkelur Neni 1, Neni 6 parg. 1 , Neni 7, Neni 59 , Neni 60 dhe Neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1 të LPP-së Neni 69 paragrafi 8 dhe Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik. Kërkojmë nga PSH i OSHP-së që të detyrojë Autoritetin Kontraktues të merr për bazë faktet e paraqitura dhe të anuloi Njoftim mbi vendimin e datës: 29.11.2023 dhe të kthej lenden në ri-vlerësim ku do të shpall fitues grupin e OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk sipas vlerësimit të komisionit të parë të datës 22.11.2023, pasi qe ky vlerësim ka qenë i drejt në pajtueshmëri me kërkesat e FTD të dosjes se tenderit dhe dispozitat e LPP-në, pa interes të individëve apo grupe të individëve brenda AK-së, dhe një heri Grupi i Operatoreve Ekonomik Alfa Globe & Eor Group Shpk plotësojmë kërkesat e dhëna ne FTD të dosjes të tenderit dhe kemi çmimin me të lirë të ofruar me ofertë që është brenda buxhetit të paraparë nga Autoriteti Kontraktues. Bazuar në faktet e latë cekura dhe Nenit 62 paragrafi 2 dhe 2.1 Autoriteti Kontraktues në këtë fazë nuk mundë të ndërpresë aktivitetin. Kërkojmë nga Paneli shqyrtues i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues qe të respektoj LPP-në dhe të kthehet lënda në rivlerësim ku ankesa e jonë do të shqyrtohet konform dhe duke e

respektuar LPP-në, pasi qe në bazë të kërkesave të njoftimit për kontratë dhe FTD të dosjes se tenderit dhe vlerësimit të komisionit të pare të Autoritetit Kontraktues ne jemi të përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe një heri jemi OE i përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin më te lirë. Bazuar në faktet e lart cekura drejtohemi me Ankesë në OSHP për mbrojtje të ligjshmërisë të ofertës së dhënë nga grupin e OE-ve Alfa Globe Shpk & E Eor Group Shpk. Kërkojmë nga PSH I OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të kthej lenden në ri vlerësim, të anuloi vendimin e datës 29.11.2023, duke e respektuar kërkesat e dhëna me FTD të dosjes se tenderit dhe bazuar në LPP-në ,pasi qe në bazë të kërkesave të FTD të dosjes se tenderit dhe letrës standarde të Autoritetit Kontraktues të datës 22.11.2023 ku Autoriteti Kontraktues e vlerëson se grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk është i përgjegjshëm dhe vlerësuar pozitivisht ku dhe shpall Njoftimit për vendimin për kontratë ku shpërblehet grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & E Eor Group Shpk . Grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk kërkon të rishqyrtoj vendimin për njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 29.11.2023, pasi që është vendim i marrë në kundërshtim me: Neni 1, Neni 6, Neni 7, Neni 59, Neni 60 dhe Nenin 62, 69 të LPP-së Bazuar në letrën standarde për tenderuesin dhe njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 29.11.2023, konsiderojmë se është vendim kundër thënës në mes të vendimit të datës 22.11.2023 kur Autoriteti Kontraktues e shpërblen me kontratë grupin e OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk ku komisioni ka vlerësuar drejtë dokumentacionin bazuar në kërkesat e FTD të dosjes se tenderit dhe vendimit 29.11.2023 kur pas kërkesës se paraqitur për ri shqyrtim nga një OE pjesëmarrëse në tender, komisioni i vlerësimit të AK-së pas kërkesës për ri shqyrtim nga OE Bleta Shpk, ka bër shkelje të rënda të dispozitave të LPP-së gjatë vlerësimit, dhe kur jep arsyetimin e eliminimit në letren standarde për tenderuesit e eliminuar për grupin e OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk nuk pajtohet me këtë ARSYETIM të AK-së: Pas kërkese për rishqyrtim të OE bleta Autoriteti Kontraktues e aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën e OE Bleta Shpk dhe e kthen aktivitetin në rivlerësim. Komisioni i rivlerësimit ka ber shkelje të rënda të dispozitave të LPP-së qe i kemi cekur me lartë dhe arsyetimet e dhëna nga AK me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar nuk qëndrojnë. Komisioni i rivlerësimit të Autoritetit Kontraktues me dashje apo pa dashje thirret në Rregullore Nr.001_22 për prokurim publik, 26.5, duke u përpjekur të Lajthitë grupin e OE-ve Alfa Globe & Eor Group Shpk, Nr.001_22 për prokurim publik, thotë 26.5: kurse neni 66.2 (Autorizim/Licenca), tregon qartë se nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale : Komisioni i rivlerësimit bën shkelje të rënd kur nuk respekton Neni 71 paragrafi 4 të LPP-së për aktivitetin: Konkluzion Komisioni i rivlerësimit me dashje apo pa dashje i ka përdorur gabimisht dispozitat e LPP-së duke u thirre në dispozita të gabuara për këtë aktivitet, pasi qe këtu kemi të bëjmë me furnizim dhe për grupin e OE-ve duhet të zbatohet Neni 70 paragrafi 4 dhe bazuar në këtë dispozitë grupi i OE-ve Alfa Globe & Eor Group Shpk është i përgjegjshëm dhe në pajtueshmëri me kërkesat FTD të dosjes se tenderit dhe dispozitat e LPP-së. Sa i përkite pretendimit të dytë të komisionit të rivlerësimit edhe me këtë rast ky komision me dashje apo pa dashje shkel rënd Neni 7 të LPP-së. Pasi qe në FTD të dosjes se tenderit të Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të Kërkesa 3: kërkohet : Grupi i OE-ve Alfa Globe & Eor Group Shpk me ofertë ka bashkangjitur Licencën Valide dhe të noterizuar nga origjinali; Dhe bazuar në kërkesat e FTD të dosjes se tenderit Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 &7.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3: Licenca Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali; Grupi i OE-ve Alfa Globe & Eor Group Shpk me ofertë ka bashkangjitur Licencën e lëshuara nga MBPZHR-DPBT, prandaj përsëri komisioni i rivlersimit edhe me këtë rast shkel rënd Nenin 7 të LPP-së dhe FTD të dosjes se tenderit duke kërkuar në kundërshtim me LPP-në dokumentet të cilat nuk janë kërkuar në Njoftimin me kontratë ose në FTD të dosjes se tenderit, prandaj Arsyetimi i dhënë nga komisioni i rivlerësimit nuk qëndron. Komisioni i rivlerësimit me dashje apo pa dashje i ka përdorur gabimisht edhe të dhënat nga MBPZHR e të cilat nuk

kanë qenë kërkesë në FTD aq me keq kur edhe kjo e dhënë nuk është respektuar nga Autoriteti Kontraktues sepse grupi i OE Alfa Globe & Eor Group Shpk e plotëson edhe ketë kërkese apo kriter. Bashkangjitur gjeni e-malin zyrtar nga Institucioni përkatës për importin dhe certifikimin e kualitetit te plehrave artificiale. Konkluzion Shkeljet e rënda të LPP-së të cilat i ka bërë komisioni i rivlerësimit ngritin dyshime se po favorizohet ndonjë OE-tjetër pjesëmarrëse. Kërkojmë nga PSH I OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues që të merr për bazë faktet e paraqitura dhe të anuloi Njoftim mbi vendimin e datës: 29.11.2023 dhe të kthej lenden në ri-vlerësim ku do të shpall fitues Grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk sipas vlerësimit të komisionit që ka dhënë vendimin e datës 22.11.2023, pasi qe plotësojmë kërkesat e dhëna ne FTD të dosjes të e tenderit dhe një herit kemi çmimin me të lirë dhe jemi brenda buxhetit të paraparë nga Autoriteti Kontraktues. Duke marr për bazë faktet e lartë cekura, na dyshojmë se më këtë anulim të vendimit të datës 22.11.2023, individ apo grup i individëve nga Autoriteti Kontraktues për interesa personale apo interesa të grupit ka ndërhyrë dhe kanë ndikuar pasi qe kërkesa për rishqyrtim e OE Bleta Shpk është e pa bazuar në fakte, nën ndikim apo presione, kërkesa për rishqyrtim e OE Bleta Shpk edhe pse pa kurrfarë baze të LPP-së është marr si e bazuar nga AK-ja dhe anëtarët e komisionit të ri në rivlerësim kanë shkel rënd dispozitat e lartë cekura të LPP-së pasi që grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk është i përgjegjshëm dhe çmimin më të lirë dhe brenda buxhetit të paraparë nga AK-ja, AK-ja përkundër qe grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk është i përgjegjshëm ka marr vendimin e datës 29.11.2023 për anulimin e tenderit që është në kundërshtim me nenin 62 paragrafi 2 dhe 2.1 i LPP-së. Deri sa komisioni i vlerësimit nuk kishte ndikim nga individ apo grup i individve të interesit për këtë aktivitet, OE Alfa Globe Shpk & Eor Group SHPK është vlerësuar grup i OE-ve i përgjegjshëm. Grupi i OE-ve Alfa Globe & Eor Group Shpk është i përgjegjshëm dhe në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe FTD të dosjes të tenderit si dhe ka ofertuar me çmimin me të lirë që është çmim brenda buxhetit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues. "

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Alfa Globe" Sh.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 59, 60, 62, 69 të LPP-së. Andaj kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoriteti Kontraktues të anuloi vendimin e datës 29.11.2023 dhe të kthejë lenden në rivlerësim, që të merr: Vendim te Aprovohet e bazuar Ankesa e grupit të OE-ve Alfa Globe & Eor Group Shpk lidhur me tenderin "Furnizim me pleh artificial" i iniciuar nga Komuna e Rahovecit. Të Anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues Komuna e Rahovecit për Njoftimin mbi Vendimin e AK e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet bazuar në kërkesat e FTD të dosjes së tenderit dhe të kthehet vendimi i drejtë i dates 22.11.2023, fitues te shpallej grupi i OE-ve Alfa Globe Shpk & Eor Group Shpk.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: "Ju sqarojmë se pretendimet e juaja ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 3: Licencë për importim dhe eksport të plehrave; Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3: Licenca Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali; Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar si Grup i Operatorëve Ekonomik, Licencë për importim dhe eksport të plehrave është dorëzuar vetëm nga ALFA GLOBE SH.P.K. dhe jo nga Secili anëtar i grupit individualisht, ku Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik, thotë: 26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca),

nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Po ashtu ne baze te Specifikave teknike te kërkuara tek Përshkrimi i Çmimeve dhe Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Dosjes se Tenderit, Operatori Ekonomik: ALFA GLOBE SH.P.K. nuk posedon Licence për produktin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues Regjistrin e plehrave artificiale, qe lejohen te importohen, qarkullojnë dhe përdoren ne Republikën e Kosovës, bashke me kompanitë e licencuara për plehrat përkatëse, e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural mund ta gjeni ne linkun e mëposhtëm: Regjistri i plehrave artificiale të regjistruar në,MBPZHR,12.09.23.pdf (mbpzhrks. net) 3 Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi."

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 990/2023, ndërsa me datë 26.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/990 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh këtë eksperti shqyrtues i rekomandon panelit te OSHP qe te aprovoj ankesën e operatorit ekonomik dhe te kthehet procedura ne rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e ekspertit.

*Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0990, të pretendimeve ankimore të OE "Alfa Globe" Sh.P.K ankues, si në vijim;*

Konstatimi i parë (I): "Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit ka ber anulimin e aktivitetit te prokurimit konform Nenit 44.6 te RRPP me arsyetimin se as një nga operatoret ekonomik ofertues nuk plotësojnë kriteret e dosje se tenderit. AK operatorin ekonomik ankues e ka eliminuar me këto arsye te vendosura ne Letrën standarde për eliminimin. Pretendimi ankimor i Gr.te ALFA GLOBE & EOR GROUP SHPK ka te bej me eliminimin lidhur me mos plotësim te kërkesave te Dosjes se tenderit konkretisht Kërkesa nr.3 Licenca për eksportim dhe importim te plehrave Përgjigja e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimore te Gr. te OE, ve: AK ne dosjen e tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika 7.1 dhe 7.2 është kërkuar: Kërkesa nr.3. Licenca për eksportim dhe importim te plehrave Dëshmia nr.3. Licenca Valide, dhe Kopja e noterizuar nga origjinali Ne baze te pretendimeve ankimore te Gr. te operatoreve ekonomik ne cilësinë e ekspertit shqyrtues kam analizuar komplet dokumentacionin e ofertës se dorëzuar nga ana e grupit te operatoreve ekonomik ankues dhe analizimin e pretendimit ankimore. Operatoret ekonomik ne baze te LPP Nenit 71 dhe Dosjes se tenderit pikës 11.1 ka dorëzuar marrëveshjen e bashkëpunimi, konzorciumit qe dëshmon se veprojnë si grup i përbashkët ne këtë procedure. Ne baze te marrëveshjes se konzorciumit Nenit 2 palet jane pajtuar qe lider i grupit te jete operatori ekonomik ALFA GLOBE SHPK me seli ne Prishtine, ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj dhe vlerësoj se marrëveshja është e hartuar dhe kompletuar konform LPP Nenit 71, RrPP Nenit 26 pikës 26.1 dhe Dosjes se tenderit pikës 11.1. Po ashtu kjo sqarohet edhe me Nenin 71 i LPP paragrafi 4 i këtij neni thekëson shumë qartësi se Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Andaj qëllimi i krijimit te grupit apo konzuorciumit është plotësimi i dokumentacioneve te përbashkëta lidhur me kërkesat. Grupi i operatoreve ekonomik, ne ofertën e tyre ka prezantuar dy (2) licenca: 1. Licencë për Tregtimin e plehrave artificiale ne Kosovë, Nr. Protokolli 2148 dhe nr. Zyrtar

38/2023 me afat e vlefshmërisë deri me 05.06.2026 te lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. 2. Licencë për Importimin e plehrave artificiale ne Kosovë, Nr. Protokolli 2149 dhe nr. Zyrtar 09/2023 me afat e vlefshmërisë deri me 05.06.2026 te lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Te njëjtat e përmbajnë edhe noterizimin me nr. LRPK.9191/2023 Te njëjtat janë sqaruar dhe vërtetuar edhe nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit drejtuar Grup te operatoreve ekonomik te cilët e kanë bashkangjitur si dëshminë ne kërkesën e tyre për rishqyrtim. Shih licencat e grupit te operatoreve ekonomik te prezantuar ne dokumentacionin e ofertës. Duke pasur parasysh këtë ne cilësinë e eksperti konstatoj se grupi i operatoreve ekonomik ka prezantuar licencat e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe bazuar ne ketë AK gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te ofertave nuk e ka bërë konform Nenit 59, 69 dhe Nenit 71 te LPP si dhe kritereve te dosjes se tenderit dhe si rezultat i kësaj pretendimi ankimor i Gr .te OE-ve është i bazuar."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alfa Globe" Sh.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alfa Globe" Sh.P.K janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alfa Globe" Sh.P.K dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alfa Globe" Sh.P.K janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1"., që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar AK që aktiviteti i prokurimit me "Furnizim me pleh artificial" me nr. të prokurimit: "623-23-10579-1-1-1"., të Ri-vlerësohet dhe Autoriteti kontraktues Komuna Rahovec, të veproj sipas Konstatimeve të Raportit të ekspertit shqyrtues, të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LLP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në

mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- OE - **ALFA GLOBE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: